



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AGJENCIA E SHERBIMEVE PUBLIKE BERAT

Nr. ____ prot

Berat, më ____/____/2023

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Mall

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS:

Blerje materiale të ndryshme ndërtimore derrase dhe aksesore per uren e Gjerovenit”.

**KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): 44110000-4-
Materiale ndërtimi**

VLERA E FONDIT LIMIT:

912,650 (Nentëqind e dymbëdhjete mijë e gjashtëqind e pesëdhjete) leke pa TVSH.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”,autoriteti/enti kontraktor Agjencia e Sherbimeve Publike Berat ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

Shtojca 7

1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PRANIMIT/KUALIFIKIMIT

Ofertuesi deklaron se:

- a) është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;
- b) nuk është në proces falimentimi (status aktiv);
- c) nuk është dënuar për ndonjë vepër penale, në përputhje me nenin 76/1 të LPP-së;
- ç) personi (personat) që veprojnë si anëtar i organit administrativ, drejtori ose mbikëqyrësi, aksioneri ose ortaku, oseqë ka fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda Operatorit Ekonomik, nuk është i dënuar ose nuk ka qenë i dënuar nga një vendimi i gjykatës i formës së prerë për çdo vepër penale, të përcaktuar në nenin 76/1 të LPP-së;

- d) nuk është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë në lidhje me veprimtarinë profesionale;
- dh) Operatori Ekonomik nuk ka pagesa pashlyera të taksave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore, ose ndodhet në një prej kushteve të parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së;
- e) Operatori Ekonomik ka paguar energjinë elektrike dhe plotëson kërkesat që burojnë nga legjislacioni në fuqi. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.
- f) Operatori Ekonomik nuk është në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;
- g) Operatori Ekonomik ushtron veprimtarinë në përputhje me legjislacionin përkatës mjedisor, social dhe të punës;
- gj) Operatori Ekonomik ka paraqitur një Ofertë të pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;
- h) Operatori Ekonomik kryen aktivitetin në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi.
- i) operatori ekonomik nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë/kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të përfituar fonde publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.

Nëse gjuha e përdorur në procedurë është gjuha shqipe, atëherë dokumentet e gjuhës së huaj duhet të shoqërohen nga një përkthim i noterizuar në shqip.

Këto kritere duhet të përmbushen me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas Shtojcës 8.

Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, secili anëtar i grupit duhet të paraqesë Vetëdeklarimin e lartpërmendur.

Në rast se operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, Vetëdeklarimi i lartpërmendur duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.

Kriteret e Përgjithshme të Pranimit nuk duhet të ndryshohen nga Autoritetet Kontraktore.

Në çdo rast, Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga Operatori Ekonomik, për sa më sipër.

Nëse oferta paraqitet nga një bashkim Operatorësh Ekonomikë, do të paraqitet :

- Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Operatorëve Ekonomikë, ku caktohet përfaësuesi, përqindja e pjesëmarrjes në bashkim, dhe elementët që merr përsipër të realizojë secili prej anëtarëve të bashkimit.
- Nëse, një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai i vërteton autoritetit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme, duke dorëzuar një angazhim me shkrim të këtyre subjekteve për këtë qëllim.

Kriteret e përgjithshme përmbajne listën e dokumentacionit, ligjor dhe administrativ, të kandidatëve/ofertuesve, që duhet të plotësojnë për të marrë pjesë në procesin e prokurimit, në përputhje me nenin 76 dhe 77 të LPP-së, nr.162 date 23.12.2020 “Per prokurimin Publik”.

Kriteret e përgjithshme për pranimin e operatorëve pjesëmarrës janë të pandryshueshme dhe janë vënë të njëjta me Dokumentet Standarde të Tenderit sipas Vendimit Nr. 03 Datë 09.06.2021 të miratuara nga APP.

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMI

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

- a. *Formularin e Ofertës, sipas Shtojcës 1*
- b. *Sigurim oferte, sipas Shtojcës 3 ;*
- c. *Formulari përmbledhës i vetdeklarimit shtojca 8*

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Përshatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale:

Sipas percaktimeve të bëra në Shtojcën 7 të DST-ve (**Kriteret e Përgjithshme të Përzgjedhjes/Kualifikimit**).

2.1.2. Të jetë i specifikuar në QKB objekti i veprimtarisë së operatorit ekonomik i njëjte ose ekuivalent me objektin e prokurimit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenin 39, pika 6/b, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin **vërtetim për xhiron vjetore për 3 (tre) vitet e fundit financiare (2020-2021-2022)**, ku vlera e xhiros për të paktën njërin nga vitet e periudhës së kërkuar, duhet të jetë **jo më e vogël se 40%** e vlerës së parashikuar të kontratës.

Argumentimi:

Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në **nenin 77 pika 3 i LPP**, si dhe **nenin 43 pika 5 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”**.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Vendosja e këtij kriteri kualifikues i shërben Autoritetit Kontraktor për të vërtetuar se operatori ekonomik fitues i zoteron të gjitha kapacitetet ekonomike dhe financiare për të përmbushur me sukses kontratën.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në ky kriter kualifikues i shërben Autoritetit Kontraktor për të vërtetuar se operatori ekonomik

fitues i zoteron te gjitha kapacitetet ekonomike dhe financiare per te permbushur me sukses kontraten.

2.2.2 Kopje të vërtetuar të bilancit për vitet (2020,2021, 2022), të paraqitur dhe konfirmuar pranë autoriteteve përkatëse me nënshkrim dhe vulë si dhe të shoqëruara me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabël të Autorizuar, vetëm në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve të **Ligjit nr.25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”**, ku bilancet e dy viteve të njëpasnjëshme, nuk duhet të kenë raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivit, të konfirmuar nga administrata tatimore.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 43, pika 4 i VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

2.2.3 Vetëdeklarim për shlyerjen e taksave vendore të parashikuara nga Pushteti Vendor për vitin 2023, ku të përfshihet kësti për periudhën përkatëse të maturuar sipas Ligjit Nr.9632 datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar.

Kjo kerkese do te konsiderohet e permbushur gjate fazes se ofertimit me plotesimin e formularit te vetedeklarimit. Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti kontraktor do ti kërkojë ofertuesit të kualifikuar i pari, dorëzimin e dokumenteve të deklaruar si më lart.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar në nenin 77, pika 3, e LPP, nenin 43, pika 6, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, si dhe ligjin Nr.9920 date 19.05.2008 “Për procedurat tatimore” i ndryshuar, neni 4, pika 2, gërma d) dhe në ligjin Nr.9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar.

Ky kriter shërben për të garantuar Autoritetin Kontraktor se operatorët ekonomikë pjesëmarrës në këtë procedurë prokurimi, kanë kapacitetet e duhura ekonomike dhe financiare si dhe janë të përshtatshëm për të kryer veprimtari profesionale. Referuar sa më sipër, Autoriteti Kontraktor gjykon se kriteri i vendosur lidhur me dorëzimin nga ana e operatorëve ekonomikë të deklaratës për shlyerjen e detyrimeve vendore për vitin 2023 sipas kësteve pranë bashkisë/ve ku operatori ekonomik ushtron aktivitetin e tij është në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi e konkretisht me ligjin Nr.9632, datë 30.10.2006 për “Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar. Të gjithë subjektet që ushtrojnë veprimtari biznesi kanë detyrimin ligjor të regjistrimit pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit për të bërë të identifikueshëm vendodhjen e aktivitetit të tyre dhe për t’iu nënshtruar pagesës së taksave vendore të parashikuara shprehimisht në këtë ligj.

Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit **nga data e zhvillimit të procedurës**, shërbimeve vlera totale e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të vogël se 20% të vlerës së përlllogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar brenda tri viteve të fundit, **nga data e shpalljes së njoftimit të kontrates**.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

a) për përvojën e mëparshme të realizuar me **sektorin publik**, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik ose fatura tatimore të shitjes, ku shënohen

datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara,

b) për përvojën e mëparshme të realizuar me **sektorin privat**, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, **të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore**, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara."

Argumentimi: Pika 2.3.1 Bazuar në Ligjin nr.162 datë 23.12. 2020 "Për Prokurimin Publik" neni 77 pika 1/"c" dhe pika 4 si dhe VKM nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik" neni 40 pika 4. Kërkesa për dëshmi të furnizimeve të mëparshme të ngjashme, lind si domosdoshmeri për të faktuar se OE disponojnë eksperiencën dhe kapacitetin e duhur, për të përballuar kërkesat e Autoritetit Kontraktor për mallin në fjalë, objekt prokurimi.

2.3.2 Operatori ekonomik duhet të **disponojë një kamion vetëshkarkues** për transportin e mallit objekt prokurimi, për të cilin duhet të paraqesë dokumentat e mëposhtem:

- **Aktin e pronësisë së mjetit përkatës;**
ose
- **Kontratën noteriale të marrjes me qira të mjetit**, shoqëruar me dokumentacionin përkatës të pronësisë së mjetit që ka pronari, i cili e jep me qira.

Për mjetet që shënohen **në regjistra publikë** (qoftë në pronësi apo dhe me qira) duhet të paraqitet dokumenti që vërteton regjistrimin e mjetit (leje qarkullimi), çertifikata e kontrollit teknik, siguracionin e mjetit, taksat vjetore si dhe lejen e transportit për vetë ose të tjerë për ato mjete që pajisen me leje transporti sipas legjislacionit në fuqi.

Ky kriter do të përmbushet nga OE me anë të Formularit Përmbledhës së Vetëdeklarimit. Dokumentacioni provues, i cili vërteton disponimin e mjeteve, do të dorëzohet vetëm nga operatori ekonomik i shpallur fitues përpara publikimi të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afatave të ankimit.

Argumentim: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" dhe nenit 40, pika 5/ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion mjetet dhe pajisjet teknike për të përmbushur kontratën, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit

2.3.3 Operatori ekonomik duhet të paraqesë çertifikatën e mëposhtme:

- **ISO 9001:2015 ose ekuivalente** mbi "Sistemet e menaxhimit të cilësisë" lëshuar nga Institucionet zyrtare të akredituar për këtë qëllim.

Çertifikata e mesiperme duhet të jetë e lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtare akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Kriteri **2.3.3** është vendosur në përputhje me Nenin 40 pika 6 germa c të VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", bazuar në nenin 44 pika 1 të VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 si dhe bazuar në nenin 79 të LPP.

Ky kriter është vendosur që AK të ketë sigurinë që operatori ekonomik që do të ofertojë të jetë i pajisur me çertifikatën e menaxhimit të cilësisë gje e cila krijon bindjen dhe sigurinë të AK që OE do të ofertojë produkte të certifikuar të një cilësie të mirë e në përputhje me standartet

2.3.4 Operatori/et Ekonomik duhet të paraqes/in deklarate qe furnizimi do te behet me mjetet dhe shpenzimet e operatorit ekonomik fitues prane Ambienteve te percaktuar nga autoriteti kontraktor Agjencia e Sherbimeve Publike Bashkia Berat.

2.3.5 Ne rast se malli objekt prokurimi, nuk ploteson kerkesat dhe standartet teknike, nuk do te merret ne dorezim.

Kontrolli lidhur me sasine, cilesine dhe elementet e tjere teknik do te behet nga nje komisioni i veçante i ngritur nga titullari i Autoritetit Kontraktor (AK) perpara procedures se marrjes ne dorezim te mallit.

SPECIFIKIMET TEKNIKE

1) ÇIMENTO

Duhet te jete “Portland”, M400 ose ekuivalent ne thase 50kg, dhe ne perputhje me kushtet e Standartit Shteteror STASH-501-87. Çertifikata e cilesise dhe fletet e analizave te fabrikave qe kane prodhuar çimenton duhet te shoqerojne cdo furnizim sipas porosise se Autoritetit kontraktor, duke vertetuar qe çimentoja eshte e testuar dhe ka plotesuar kerkesat e permendura me lart. Transporti ne objektet e magazines duhet te behet nga Operatori ekonomik ne paketa origjinale te shenuara direkt nga fabrika e prodhimit te çimentos dhe te rruajtura ne kushtet e duhura.

Argumentim : Specifikimet e këtij malli vendosen në referim të DPS (STASH).

- 2) **KAPAK ZGARE GIZE** Duhet te jete me permasa 45*70 cm per puseta KUL . Duhet te jene prej Gize dhe te plote ,te qendrushem ndaj peshave te renda dhe rezistent ne perkulje. Gjate furnizimit te shoqerohen me certifikate cilesie.
- 3) **BITUM**. Malli duhet te jete I lengshem, konform KTZ (kriterete teknike shqiptare).
- 4) **DERRASE PISHE E SHARRUAR T=5 CM**. Derrasa duhet te jete e stazhionuar, te plotesoje kerkesat e qendrushmerise, dhe pa nyje. Gjatesia e derrases duhet te jete 4 m linear.
- 5) **DERRASE PISHE E SHARUAR T=3 CM**. Derrasa duhet te jete e stazhionuar, te plotesoje kerkesat e qendrushmerise, dhe pa nyje. Gjatesia e derrases duhet te jete 4 m linear.
- 6) **DERRASE BREDHI**. Derrasa duhet te jete e stazhionuar, te plotesoje kerkesat e qendrushmerise, dhe pa nyje. Gjatesia e derrises duhet te jete 4 m linear.
- 7) **BULONA**. Duhet te jene cilesore me permasa 6*80ml.
- 8) **GOZHDA**. Duhet te jene cilesore me permasa 6*80ml.

Vendosja e specifikimeve për këto mallra bëhet për arsye të përshtatjes sipas kërkesës dhe për të garantuar cilësinë dhe jetëgjatësisë që duhe të kenë këto mallra.

Në hartimin e këtyre specifikimeve jam referuar tek Katalogu i Standardeve të DPS (STASH).

Grafiku i levrimit të mallrave:

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

*Specifikimet teknike janë hartuar duke marrë në konsideratë nevojat e Autoritetit Kontraktor, për mallrat objekt procedure prokurimi, duke perlllogaritur sasitë e nevojshme, karakteristikat e duhura dhe standardet e duhura kombetare dhe nderkombetare, sipas parashikimeve të nenit 36, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 40, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, **duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar**, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”. sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.*

NJESIA E PROKURIMIT

MIRATOHET

TITULLARI I AUTORITETIT KONTRAKTOR

Bledar Çili